VENDIM
Nr. 210, datë 20.4.2018

PËR KRIJIMIN E FONDIT NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE TË REJA *START-UP*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar, të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja *Start-up*, për një periudhë zbatimi prej 3 (tre) vjetësh, me vlerë të përgjithshme 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Sipërmarrje e re ose *Start-up* do të konsiderohet një ndërmarrje e sapokrijuar dhe në kërkim të tregjeve.

3. Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja *Start-up*, i krijuar në zbatim të këtij vendimi, do të financohet nga buxheti i shtetit dhe mund të ketë si burime financimi edhe fonde nga donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare. Përfitimi nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucionet financiare ndërkombëtare për këto sipërmarrje nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga ky fond.

4. Fondi ka për qëllim mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre vetëm në:

a) Sektorët prodhues e të shërbimit;

b) Sektorin e industrisë së lehtë;

c) Sektorin e turizmit;

ç) Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;

d) Procesin e agropërpunimit;

dh) Fushën e dizenjimit, të modelimit dhe të artizanatit.

5. Përfitojnë nga Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja *Start-up* sipërmarrjet e reja, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë në sektorët e sipërpërmendur dhe janë të regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për një periudhë 0–2 vjet.

6. Fondi mbulon 70% të kostove të pranuara e të miratuara nga komisioni vlerësues, në varësi të projektit konkurrues, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

7. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

a) Investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/të shërbimit;

b) Marketing të produktit dhe promovim (me përjashtim të reklamave elektronike e televizive);

c) Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive sipërmarrëse, të dëshmuar me certifikatat përkatëse;

ç) Krijim faqeje interneti dhe publikim materialesh promovuese;

d) Pjesëmarrje në panaire ose ekspozita, brenda apo jashtë shtetit, si vizitor ose ekspozues.

8. Sipërmarrjet e reja, për të përfituar nga fondi i përmendur në pikën 1, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Të jenë ndërmarrje të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar;

b) Të kenë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit;

c Të kenë një plan biznesi ose një projekt dhe të jenë të afta për zbatimin e duhur e në kohë të aktiviteteve të propozuara;

ç) Të krijojnë, minimalisht, një vend të ri pune, brenda 12 muajve, nga momenti i përfitimit të fondit.

9. Pagesa e fondit bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në fund të përfundimit të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

10. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të reja *Start-up*, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

11. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të reja *Start-up*.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

13. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama